

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit Programi Parashkollor
Titulli i lëndës:	Filozofi e edukimit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass.dr. Shemsi Morina
Detajet kontaktuese:	Shemsi.morina@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs do t`u ndihmojë studentëve që të kuptojnë nocionet themelore të edukatës, historinë e edukimit dhe të shkollës gjatë etapave të ndryshme të zhvillimit shoqëror, konceptet e filozofëve dhe pedagogëve të mëdhenj, roli dhe ndikimi i tyre. Po ashtu kjo lende trajton edhe teoritë bashkëkohore të edukimit si: pragmatizmi, edukimi progresiv, kognitivizmi, konstruktivizmi, humanizmi etj.
Qëllimi i lëndës	Ky kurs i lëndës do të ofroj dhe shtjelloj këto qëllime: 1. Që studentët të kuptojnë zhvillimin e edukimit dhe mendimit pedagogjik nga kohërat antike deri te idetë përparimtare moderne; 2. të reflektojnë për teoritë bashkëkohore të edukimit, njohjen dhe konceptin e tyre 3. të zhvillojnë filozofinë personale dhe të ndërlidhin atë me praktikën bashkëkohore të mësimdhënies, gjatë procese të ndryshme .
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentet do të jenë në gjendje: 1. të analizojnë idetë pedagogjike të cilat pasqyrohen në praktikën e sotme të edukimit, trendet dhe konceptet e ndryshme, 2. të reflektojnë për faktorët themelore të zhvillimit të personalitetit, të njeriut në përgjithësi, 3. të krahasojnë teoritë bashkëkohore të edukatës

Literatura	
Literatura bazë:	Hajrullah Koliqi, Historia e pedagogjisë I, Prishtinë, 1997 Hajrullah Koliqi, Historia e pedagogjisë II, Prishtinë, 1998. Hajrullah Koliqi, Gruaja ndër shekuj, Prishtinë, 2009 Musa Kraja, Pedagogjia, Tiranë, 2009 Bardhyl Musai, Psikologji edukimi., Tiranë, 1999 Grup autorësh, Pedagogjia e përgjithshme, Prishtinë, 1997
Literatura shtesë:	Grup autorësh, Pedagogët e mëdhenj, Tiranë, 2000 Sofokli Garo, Sfidat e mësimdhënies, Tiranë, 1997 Xhon Djuj, Shkolla dhe shoqëria., Tiranë, 2003

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	1. Edukimi, njeriu dhe etapat e ndryshme të zhvillimit të shoqëris
Java e dytë:	2. Funkcionet dhe determinantet historike të edukatës
Java e tretë:	3. Teoritë e zhvillimit të personalitetit/ teoria nativiste, empirike, psikodinamike etj
Java e katërt:	4. Faktorët e ndertimit edukimit/ familja, entet parashkollore, shkolla etj
Java e pestë:	5. Edukimi në shoqërinë antike
Java e gjashtë:	6. „ Shkolla e vjetër“ dhe „ shkolla e re“
Java e shtatë:	7. Sistemi dhe mendimi pedagogjik i Komenskit
Java e tetë:	8. Zh.Zh. Ruso dhe „Teoria e edukatës së lirë“, dhe mendimi pedagogjik i Ruso
Java e nëntë:	9. J.H.. Pestaloci reformatör i madh i arsimit fillor, sistemi pedagogjik i tij.
Java e dhjetë:	10. Kontributi i Frebelit në edukimin parashkollor
Java e njëmbëdhjetë:	11. Pragmatizmi dhe „edukimi progresiv“

<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	12. Kognitivizmi dhe konstruktivizmi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	13. Bihevizorizmi dhe humanizmi
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	14. Teoria e intelegjencave të shumëfishta
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	15. Filozofia personale e mësuesit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Pritet që studenti ti përcjell me rregull ligjëratat dhe ushtrimet.
- Studentët duhet të mbajnë qetësi në sallë dhe të jenë të koncentruar në mësim.
- Secilit student i lejohet që të parashtrojë pyetje apo të bëjë komente kur i jepet fjala;
- Gjatë kohës së ligjëratave të shkyçen telefonat celular.